

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **MINISTRIA E INFRASTRUKTURES**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **205-25-5527-2-1-1**

Sa i përket tenderit për **Mirëmbajtja rutinore dhe dimërore të Autoudhëve A7 dhe A6 të Republikës së Kosovës për vitet 2025 2026, 2026 2027, dhe 2027 2028 per LOT 1, LOT 2, LOT 3 dhe LOT 4.**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	"SALLAHU" SH.P.K.
NUI	810135237
Adresa	Rr.Baki Dullovi Nr.158
Vendi	Kaçanik
Kodi postar	71000
Numri Telefonit	+38349745000
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Lulzim Sallahu
Adresa elektronike	nntsh_sallahu@hotmail.com
Data e parashtrimit të ankesës	15.07.2025

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Mirëmbajtja rutinore dhe dimërore të Autoudhëve A7 (Ibrahim Rugova), segmenti Morinë-Gjurgjicë-LOT 1||**Mirëmbajtja e Autoudhës A7 segmenti Bresje-Besi, rruga Nacional N9-Bresje-Gjurgjicë,udhëkryqi i Autoudhës A7 A6 deri në Besi,LOT 2.**||**Mirëmbajtja rutinore dhe dimërore të Autoudhëve A6 (Arbër Xhaferi), segmenti Kycja e Autoudhës A7 A6 me rrugën Nationale N2, Udhëkryqi Veternik deri te kycja në Ferizaj, LOT 3.**||**Mirëmbajtja e Autoudhës A6 segmenti Kycja Ferizaj- Doganaj Hani i Elezit, LOT 4.**

20.06.2025 Njoftimi per kontrate

03.07.2025-Kerkese per Rishqyrtim

08.07.2025 - Vendim mbi aprovimin e pjeserishem te Kerkeses per Rishqyrtim

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Me datë 03.07.2025 kemi paraqitur Kërkesë për Rishqyrtim lidhur me Njoftimin për Kontratë ndaj kushteve të përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

Autoriteti Kontraktues me date 08.07.2025 nxjerrë Vendim mbi aprovimin e pjesërishëm të Kërkeses për Rishqyrtim.

Pas udhëheqjes së procedurës paraprake për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, në kuptim të nenit 108/A par 7 ndërlidhur me Nenin 109 të LPP-së, duke qene pale me interes, i drejtohem i Organit Shqyrtues të Prokurimit me këtë Ankesë , për vendosje meritore ndaj pretendimeve tona të cilat jane refuzuar pa baze ligjore nga AK.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1

Neni 7

Neni 28

Neni 46

Neni 69

Rregullorja nr 01/2022 për Prokurim Publik

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Pretendimi 1

Duke u bazuar në dokumentacionin përkatës të Njoftimit për Kontratë dhe Dosjes se Tendeerit , kemi vërejtur se Autoriteti Kontraktues (AK) ka vepruar në kundërshtim me Nenin 46 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i cili lejon shkurtimin e afateve kohore vetëm në rrethana urgjente të vërtetuara dhe të justifikuara me dokumentacion përkatës ligjor.

Përkatësisht, Neni 46 paragrafi 1 dhe 2 përcakton qartë se Autoriteti Kontraktues mund të aplikojë afate më të shkurtra vetëm nëse mund të dëshmojë që shkurtimi i afatit është i domosdoshëm për shkak të një rasti urgjent, të paparashikueshëm dhe që nuk ka rezultuar si pasojë e veprimeve apo neglizhencës së vetë autoritetit.

AK pretendon se ka shkurtuar afatet kohore për pjesëmarrje në emër të emergjencave, se perfundojnë kontratat ekzistuese me 25.07.2025 , mirëpo kjo në rastin konkret është e pabazuar pasi AK i ka ditur datat dhe afatet se deri kur ka kontrata aktive dhe kur përfundojnë ato,se ka mundur qe te inicioje proceduren e prokurimikt kohe me pare.

Duke qene se MMPHI ka bere shkurtimin e afateve ligjore pa asnje rrethane dhe arsye te justifikueshme, rezulton se nuk eshte respektuar Neni 46 i LPP-se, dhe se AK a bere shkurtimin e afateve pa a pasur asnjë emergjencë të papritur apo të paparashikueshme që të arsyetonte shkurtimin e afateve për dorëzimin e ofertave.

Për më tepër, shkurtimi i afateve pa arsyetim të plotë ligjor dhe pa prova bindëse të nevojës emergjente për ndërhyrje, përbën shkelje të parimit të konkurrencës së lirë dhe mund të rezultojë në kufizimin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë, si dhe në marrjen e ofertave më pak të përgjegjshme.

Prandaj, përmes Kërkesës për Rishqyrtim kemi kërkuar zbatimin e plotë të Nenin 46 të Ligjit për Prokurimin Publik, duke respektuar afatet e rregullta të dorëzimit të ofertave në procedura të hapura , mirëpo ky pretendim është refuzuar nga Autoriteti Kontraktues pa asnjë arsyetim, andaj kërkojmë të trajtohet nga OSHP.

Pretendimi 2

Ne lidhje me kërkesën nr 5 te FDT-së : Lista e kontratave te realizuara perfunduara ne lëmine e kërkuar për periudhën e shkuar tre vjeçare , ne lëmine e Mirembajtjes se utoudheve, rrugeve Nacionale dhe rajonale apo Ndertimit, Zgjerimit e Rehabilitimit te Rrugeve Nacionale dhe rajonale per periudhen e shkuar tre vjecare.

Përmes Kërkesës për Rishqyrtim, kemi kërkuar qe ne kete kerkese të Dosjes se te perfshihen edhe kontratat e realizuara, perfunduara ne lemin e ndertimit ,zgjerimit apo rehabilitimikt te rrugeve lokale pasi qe edhe keto kontrata duhet te jene te pranueshme nga AK pasi qe jane ne lëmine e kerkuar.

Neni 69 paragrafi 6.2. I ligjit të prokurimit parasheh : ‘’ listën me të cilën specifikohen të gjitha projektet e punëve dhe aktivitetet ndërtimore të realizuara në periudhën e shkuar trevjeçare, të përcjella me certifikata për kryerje dhe/ose përfundim të kënaqshëm të projekteve më të rëndësishme të punëve dhe/ose aktiviteve ndërtimore; certifikatat përcaktojnë vlerën, datën dhe vendndodhjen e projekteve të punëve dhe/ose aktiviteve ndërtimore dhe specifikojnë nëse janë kryer dhe/ose përmbushur në përputhje me rregullat tregtare dhe janë përfunduar siç duhet; sa herë që është e mundur, autoriteti kontraktues mund të obligohet që të dakordohet me autoritetin publik kompetent në Kosovë ose në vendin tjetër që kopjet e certifikatave përkatëse t’ia paraqes drejtpërdrejtë autoritetit kontraktues’’.

Ak ka korigjuar piken 5 te kesaj kerkese, ndersa pika 5.1 e kesaj kerkese eshte mbetur e pa ndryshuar.

Pretendimi 3

Ka qene i parashtruar ne lidhje me Listen e paisjeve , pika 1.3 ku eshte kerkuar Cilinder vibrues me rrota hekur - hekur me peshe 2-5 ton , 2 cope, ku kemi kerkuar qe tek kapaciteti te vendoset minimumi prej 2ton pa kufizime , per shkak se nje kerkese e tille eshte diskriminuese/favorizuese dhe si e tille cenon konkurrencen e lire dhe pa mundeson operatoret ekonomik ne plotesimin e kesaj kerkese. **AK e ka aprovuar kete pretendim dhe e ka korrigjuar kerkesen ne DT.**

Pretendimi 4

Ne lidhje me Listen e paisjeve tek kerkesat per paisjet dimerore , pika 3.2 ku eshte kerkuar Automjete transportuese kamion te pajisur me Boreheqese pllugjet dhe shperndaresit automatik te kripes me kapacitet min .te motorrit 110 KW (min 10) , ku kemi kerkuar nga AK qe lidhur me kapacitetin e motorit prej min 110kw te largohet si kerkese sepse eshte e pa nevojshme dhe sjelle veshtiresi tek operatoret ekonomik ne plotesimin e kerkeses,nuk ndikon ne realizimin e kontrates, dhe paraqet vetem veshtiresi per Autoriteti Kontraktues gjate vleresimit te tenderëve, sepse shumica e paisjeve ne dokumentacion psh dokument unik doganor nuk e kane te percaktuar fare kapacitetin e motorrit, andaj per ne eshte kerkese e vendosur qe nuk siguron qasjen me te mire per te gjithë operatorët ekonomik te interesuar.

Sipas nenit 7 dhe 28 te LPP-se , perpilimi i kushteve dhe kriterëve duhet te behet ne perputhje me qellimin dhe te drejtuara drejt sigurimit te qasjes sa me te mire per te gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit, gjithmone ne perputhje , me standardet e aplikueshme sipas ligjit.

Konform nenit 28 paragrafi 2 te LPP-se, Autoriteti Kontraktues eshte vecanarishte i ndaluar qe te hartoje specifikime teknike qe favorizojne ose diskriminojne nje ose me shume operatore ekonomik.

Sipas nenit 17.17 i Rregullores nr 01/2022 Dosja e tenderit do te pergaditet ne menyre qe nuk :

- a) Kufizon konkurrencen ne mesin e OE
- b) Diskriminon kunder ose vepron ne favor te nje ose me shume OE

Ankesen tonë , të e aprovojë të njëjten si te bazuar , dhe te detyroje Autoritetin Kontraktues qe te formuloje kerkesat/kushtet e Dosjes se Tenderit ne perputhje me LPPne ne ate menyre qe kushtet dhe kriteret te mos jene diskriminuese/favorizuese dhe kunderligjore të mundësohet qasje sa më e mirë për të gjithë OE të interesuar , si te zgjase afatin per dorezimin e tenderëve sepse shkurtimi i afatit per dorezimin e tenderëve eshte kundërligjor.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Jane deme te konsiderueshme te cilat mund te na shkaktohen pasi qe nuk eshte siguruar qasje e drejte dhe e barabarte per te gjithë OE ne perputhje me standardet e aplikueshme sipas ligjit , dhe nga keto percaktime diskriminuese/favorizuese , rrezikon qe te mos trajtohen ne menyre te barabarte te gjithë OE te interesuar.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) *një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) *një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) *bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
- f) *Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*